



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

Titulli i Modullit: Kulturë dhe komunikim në fushën e turizmit
Lloji i Trajnimit: Trajnim i zhvilluar në formë hibride.
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: Shqip
Kohëzgjatja e programit të modullit: 40 orë mësimore
Nr. i krediteve: 4 ECTS

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Në kontekstin e këtij formimi universitar është e nevojshme të njihen nocionet dhe problematikat domethënëse që bashkojnë fushat e komunikimit ndërkulturor, të kuptohen dhe arsyetohen dinamikat komunikative në situatat e ndërveprimit dhe të shkëmbimit kulturor, të cilat karakterizojnë shoqërinë njerëzore në kohët e sotme.

Lënda do të zhvillohet me seminare, raste studimore, diskutime dhe punë në grup, detyrë kursi.

Lënda është konceptuar në përputhje me qasjen pjesëmarrëse dhe ndërvepruese. Si materiale mbështetëse do të përdoren dokumente autentikë, materiale audiovizive, libra, informacione në linjë, të cilat do të plotësojnë nocionet themelore të lëndës, me qëllim që studentët të familjarizohen me shumëllojshmërinë e tematikave të trajtuara dhe më pas të arrijnë t'i përdorin ato në punimet e tyre individuale. Rastet studimore që do t'u jepen studentëve në formë temash, do të shoqërohen me bibliografinë përkatëse. Gjatë seminareve do të motivohen punët në grup dhe do të nxitet ndërveprimi mes studentëve.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Qëllimi i lëndës është t'i njohë studentët me dukuritë dhe konceptet që karakterizojnë komunikimin ndërkulturor. Gjatë diskutimeve interaktive do të prezantohet një vështrim i teorive, i termave, raste studimore të cilat studentet do t'i analizojnë dhe diskutojnë.

Objektivat specifike lëndore:

- Të njihen studentët me zhvillimet më të rëndësishme, me konceptet dhe nocionet themelore të teorive të komunikimit ndërkulturor.
- Të zhvillojë te studentët mendimin kritik në lidhje me dukuritë e studiuara të komunikimit ndërkulturor
- T'u japë studentëve elemente të analizës së situatave komunikative mes pjesëmarrësve të kulturave të ndryshme

REZULTATET E TË NXËNIT:

- Njohja e teorive dhe e koncepteve baze të komunikimit ndërkulturor
- Identifikimi dhe shpjegimi i dukurive që lidhen me komunikimin ndërkulturor
- Njohja e terminologjisë
- Respektim i kulturave, vetiake dhe të Tjetrit
- Aftësi për të analizuar elementet situata apo raste të caktuara nga pikëpamja ndërkulturore
- Interes për kulturën e Tjetrit
- Aftësi për të mos paragjykuar
- Aftësi për kontrolluar pasigurinë
- Ndërgjegjësim i funksionimit të kulturës së tij (vlerat, besimet, normat, format e komunikimit fjalësor dhe jofjalësor, etj).
- Aftësi për t'u përshtatur me kulturat e tjera
- Aftësi për të respektuar ndryshimet kulturore

KONCEPTET THEMELORE:

Çështjet kryesore që do të zhvillohen sipas programit janë:

- Çështje të komunikimit gjuhësor
- Përkufizime të nocionit “Kulturë” dhe format e saj
- Qasjet dhe disiplinat e komunikimit ndërkulturor
- Aktorët shoqërorë dhe kultura e tyre
- Dukuritë e empatisë, stereotipave dhe paragjytimeve
- Kontradiktat kulturore
- Multikulturalizmi dhe ndërkulturalizmi
- Identiteti kulturor
- Roli i mediave në komunikimin mes kulturave